



# Lidership

LIGJERUES: BUTRINT **BATALLI**

# Lidership Përmbajtja

**Lidership;**

|

- ▶ *Lidershipi transformues*



*Stilet e lidershipit;*  
Lidershipi Transformues

# Lidershipi Transformues

## Përshkrimi

- ▶ Lidershipi transformues është objekt i hulumtimeve të ndryshme në vitet e 80-ta të shekullit të kaluar. Lidershipi transformues është pjesë e paradigmës së quajtur lidershipi i ri (Bryman 1992) në të cilën rëndësi e veçantë i kushtohet elementeve të lidershipit si harizma dhe ndjenjat.



# Lidershipi transformues

vazhdim

- ▶ Lidershipi transformues u përgjigjet nevojave të grupeve bashkëkohore të punës që kanë nevojë për inspirim dhe fuqizim për të arritur sukses në një kohë të pasigurisë.
- ▶ Lidershipi transformues paraqet proces në të cilën njerëzit ndryshojnë. Kjo qasje ka të bëjë me emocionet, vlerat, etikën, standardet dhe qëllimet afatgjate dhe nënkupton vlerësimin e motiveve të vartësve, plotësimin e nevojave të tyre dhe trajtimin e tyre si qenie njerëzore.



# Lidershipi transformues

## vazhdim

- ▶ Lidershipi transformues është qasje e veçantë në të cilën theksohet realizimi i ndikimit me çka vartësit/pasuesit/punëtorët do të realizojnë më tepër se ajo çka pritet nga ta. Kjo qasje bashkon lidershipin harizmatik dhe lidershipin vizionar.
- ▶ Edhe pse tek lidershipi transformues lideri ka rol qendror në përshpejtimin e ndryshimeve pasuesit dhe liderët janë të ndërlidhur në këtë proces të transformimit.



# Lidershipi transformues

- ▶ lider janë ata individ që motivojnë vartësit /pasuesit/ punonjësit me qëllim që objektivat e liderit dhe të vartësve/pasuesve/punonjësve të realizohen në mënyrën më të mirë. **James McGregor Burns**

Lidershipit transformues nënkupton ngritjen e moralit tek të tjerët

Lidershipi transformues është një stil i lidershipit, ku lideri është i ngarkuar me identifikimin e ndryshimeve të nevojshme, duke krijuar një vizion për të udhëhequr ndryshimin përmes frymëzimit, dhe ekzekutimin e ndryshimit së bashku me anëtarë të përkushtuar të grupit.



# Lidershipi transakcional vs. transformues

- ▶ Burns diferencoi lidershipin transakcional nga lidershipi transformues.
- ▶ Lidershipi transakcional ka të bëj me një numër të madh të formave të lidershipit që janë të përqendruar në shkëmbim në mes liderit dhe vartësve/pasuesve/punonjësve. Politikanët që marrin vota duke premtuar se nuk do të ketë tatime dhe taksa të reja janë shembull tipik të lidershipit transakcional. Ngjashëm, menaxherët që u ofrojnë bonuse apo avancime punonjësve nëse tejkalojnë normat e përcaktuara janë gjithashtu shembull për lidership transakcional.





# Lidershipi transakcional vs. transformues

vazhdim

- ▶ Për dallim nga lidershipi transakcional lidershipi transformues është proces në të cilën individi merret me të tjerët dhe krijon raporte me ta, me çka përmirësohet motivimi dhe morali i liderit vartësve/pasuseve/punonjësve.
- ▶ Lideri transformues është i ndjeshëm ndaj nevojave të vartësve/pasuesve/punonjësve dhe mundohet tu ndihmoj pasuesve të arrijnë potencialin e tyre.



# Lidershipi transaksional vs. transformues

Transactional leadership is a very direct style of leadership and uses rewards and punishments to motivate the team.

- ▶ Transformational leadership style is a form of leadership style that focuses on team performance as a whole by encouraging team members to think of the group rather than themselves. It is about moving forward as a team rather than individuals who just happen to be on the same project.




# Lideret transformues

- ▶ Mahatma Gandhi paraqet shembull tipik të liderit transformues, duke u ofruar miliona njerëzve shpresa dhe duke inkurajuar në kërkesat e tyre dhe duke ndryshuar në proces.



# Lidershipi transformues në botën e biznesit

- ▶ Në botën e biznesit shembull për lidership transformues do të ishte menaxheri i cili mundohet t'i ndryshoj vlerat korporative duke vendosur standarde humane kur bëhet fjalë për parimet e korrektësisë dhe drejtësisë. Në këtë proces edhe menaxherët edhe vartësit/pasuesit/punonjësit mund të tregojnë aftësi duke ngritur vlerat e tyre morale.



# Llojet e ndryshme të Leadershipit Transformues

Në modelin transformues sipas Burns ekzistojnë disa lloje të leadershipit transformues:

- ▶ **Intelektualët** - lider i përkushtuar të shoh vlera dhe ide që plotësojnë nevojat të gjithëve. Në suaza të leadershipit intelektual ekziston një vlerë dhe qëllim më i lartë moral si dhe vizion për transformimin e shoqërisë.
- ▶ **Reformues** – lider i lëvizjeve reformuese që kërkon pjesëmarrje të një numri të madh të pasuesve për realizimin e së njëjtës. Liderët reformues mund të transformojnë një pjesë të shoqërisë për realizimin e standardeve të larta të parimeve morale.

# Llojet e ndryshme të Leadershipit Transformues

vazhdim

Në modelin transformues sipas Burns ekzistojnë disa lloje të leadershipit transformues:

- ▶ **Revolucionar** - lider që kërkon nga pasuesit të jenë në gjendje të bëjnë sakrificën më sublime për të mirë e të gjithëve Gjersa lideri reformues mund të punojë në përmirësimin e një aspekti të shoqërisë lideri revolucionar mundohet të ndryshojë shoqërinë.
- ▶ **Lideri harizmatik** - paraqet llojin më të rëndësishëm të leadershipit transformues. Lideri harizmatik perceptohet si hero nga pasuesit.

# Lidershipi transformues dhe harizma

vazhdim

- ▶ Fjala harizëm është përdorur për të përshkruar një dhunti të veçantë që kanë një numër i caktuar i individëve që u mundëson të arrijnë rezultate të jashtëzakonshme. Weber 1947, ofron përkufizimin e harizmës si vijon: “karizma paraqet karakteristikë të veçantë personale që personit i mundëson pushtet mbinjerëzor dhe të jashtëzakonshëm dhe që posedohet nga numër i vogël i individëve me prejardhje hyjnore dhe si pasojë të tjerët e trajtojnë personin gjegjësisht si lider.”
- ▶ Sipas House (lidërsipit harizmatik), karakteristikat personale të liderit harizmatik nënkuptojnë dominimin, dëshirën e madhe të ndikoj tek të tjerët, vetëbesimin dhe ndjenja e fuqishme për vlerat morale të individit.

# Lidershipi transformues dhe harizma

vazhdim

- ▶ **Së pari**, këta lider paraqesin shembull për qëndrime dhe vlera të cilat dëshirojnë të aplikohen edhe nga vartësit.
- ▶ **Së dyti**, liderët harizmatik perceptohen si individ kompetent nga vartësit
- ▶ **Së treti**, ato artikulojnë qëllime ideologjike në të cilat pjesë e rëndësishme janë vlerat morale.
- ▶ **Së katërti**, liderët harizmatik kanë pritje të mëdha nga vartësit
- ▶ **Së pesti**, lideri harizmatik përmirëson motivimin e vartësve që janë orientuar në detyra dhe ngërthen përkatësinë, pushtetin dhe respektin.



# Lidershipi transformues dhe harizma

vazhdim

Karakteristikat personale	Sjellja	Ndikimi tek pasuesit /vartësit /punonjësit
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dominimi</li> <li>• Dëshira për realizimin e ndikimit</li> <li>• I besueshëm</li> <li>• Vlerat e larta</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Paraqet model</li> <li>• Tregon kompetencë</li> <li>• Përcakton qëllime</li> <li>• Ka pritje të mëdha</li> <li>• Është i besueshëm</li> <li>• Motivon</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Besim në ideologjinë e liderit</li> <li>• Ngjashmëri në besimin e liderit dhe vartësve</li> <li>• Prirje ndaj liderit</li> <li>• I dëgjueshëm</li> <li>• Identifikim me liderin</li> <li>• Përfshirje emocionale</li> <li>• Qëllime të larta</li> <li>• Besim më i madh</li> </ul>

## Modeli i lideshipit transformues

Kah mesi i viteve 80-ta Bass ofroi një model të zgjeruar të lideshipit transformues që deri në një segment bazohet në hulumtimet e Burns (1978) dhe House (1976).

Bass u kushtoi rëndësi të madhe nevojave të vartësve/punonjësve e nuk u përqendrua në nevojat e liderit.

Teoria e Bass-it, bazohej në premisën se lideshipi transformues mund të aplikohet edhe në situatat në të cilat rezultatet nuk janë pozitive.



# Modeli i lideshipit transformues

Lidershipi transformues	Lidershipi transakcional	Lidershipi liberal
<p>Faktori 1 Ndikimi i idealizuar Harizma</p> <p>Faktori 2 Motivimi inspirues</p> <p>Faktori 3 Stimulimi intelektual</p> <p>Faktori 4 Respektimi individual</p>	<p>Faktori 5 Shpërblimi potencial Transakcionet konstruktive</p> <p>Faktori 6 Menaxhmenti me anë të përgjashtimeve Aktiv dhe pasiv Transakcionet korrektuese</p>	<p>Faktori 7 Laissez-faire Jotransakcion al</p>



## Faktorët e lidershipit transformues

Lidershipi transformues përmirëson performansat e vartësve/pasuesve/punonjësve dhe mundëson arritjen e potencialit të plotë të tyre.

Liderët që kanë elemente të lidershipit transformues posedojnë vlera të fuqishme dhe ideale dhe janë efektiv në motivimin e vartësve /pasuesve/ punonjësve të veprojnë ashtu që të mbështesin realizimin e të mirave që janë mbi interesat personale.



# SI E SHPJEGON LIDERSHIPIN QASJA TRANSFORMUESE

- ▶ Qasja transformuese ofron pasqyrë si liderët mund të ndikojnë, zhvillojnë dhe implementojnë ndryshime në organizatë. Kjo qasje mundohet të fuqizoj vartësit/pasuesit/punonjësit. Liderët që implementojnë këtë qasje mundohen të rrisin vetëdijen e të tjerëve duke inkurajuar sjellje që do të tejkaloj interesat vetanake.
- ▶ Sa për ilustrim, Jung Chow dhe Wu (2003) analizuan leadershipin në 32 kompani në Tajvan dhe zbuluan se leadershipi transformues është drejtpërdrejt i ndërlidhur me inovacionin në organizatë.
- ▶ Leadershipi transformues ndikon në krijimin e kulturës në të cilën punonjësit do të ndihen të fuqizuar që të bisedojnë lirshëm dhe të provojnë qasje të reja në proceset organizative.



# Zbatimi i lideshipit transformues

- ▶ Ofron një model të përgjithësuar që përqendrohet në idealet, inspirimin, inovacionin dhe kujdesin për individin
- ▶ Ky model mund të aplikohet tek individët në çdo nivel të organizatës. Mund të përdoret në procesin e rekrutimit, selektimit, promovimit, trajnimit dhe zhvillimit.
- ▶ Gjithashtu lidershipi transformues përdoret në përmirësimin e zhvillimit ekipor, vendimmarrjen në grupe, iniciativa për përmirësimin e cilësisë dhe ristrukturimin në organizata.





Përgatiti: Butrint BATALLI

Email: [butrint@inovaconsulting.eu](mailto:butrint@inovaconsulting.eu)

[butrint.batalli@universitetiaab.com](mailto:butrint.batalli@universitetiaab.com)